



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 216/2 Prot.

Tiranë, më 06.04.2022

V E N D I M

Nr. 50, Datë 06.04.2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN INSTITUTI I
STATISTIKAVE DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË MBIKËQYRJES**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Instituti i Statistikave,

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 107, datë 13.09.2021, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Instituti i Statistikave”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Instituti i Statistikave.

Administrimi i shërbimit civil në subjektin e mbikëqyrur, si institucion i pavarur, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, “fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”.

Objekti i mbikëqyrjes është i fokusuar tek veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë aplikimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit

në shërbimin civil dhe zhvillimit të karrierës, nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 801/1 prot., datë 13.09.2021, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 801/2 prot., datë 13.09.2021, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Instituti i Statistikave”*, i është njoftuar institucionit.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 216, prot., datë 09.03.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Instituti i Statistikave, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë një afat 5 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i punës.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, përgjatë gjithë periudhës së kontrolluar, Komisioneri ka evidentuar disa aspekte problematike të zbatimit të ligjit, të cilat po i paraqesim në vijim:

→ Sa i takon pozicionit të punës *“Arkivist”*, i cili nuk përfshihet në pozicionet e shërbimit civil, njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të mbajë parasysh kërkesat e akteve nënligjore, Vendimit nr.187, datë 08.03.2017, *“Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, ...institucionet në varësi të ministrive të linjës.....”*, të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*.

Në këtë rast, duhet të saktësohet emërtesa e pozicionit të punës, të përcaktohen qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë ligjore që realizon.

Gjatë realizimit të procedurave për përgatitjen dhe propozimin e strukturës së re organizative, nëse vlerësohet se ky pozicion ka tiparet e shërbimit civil, atëherë ai duhet të trajtohet si pozicion i shërbimit civil.

→ Në lidhje me identifikimin e njësisë organizative e cila duhet të kryej rolin e njësisë përgjegjëse, subjekti i mbikëqyrur, duhet të marrë masa për plotësimin e emërtesës së *“Drejtorisë së Financave dhe Projekteve”*, duke përcaktuar qartësisht në strukturë njësinë organizative në nivel drejtorie, ku realizohen funksionet e administrimit të burimeve njerëzore, në mbështetje të argumentimit ligjor të përmendur në Raportin e mbikëqyrjes.

→ Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, ka përgatitur planin e nevojave për rekrutim për secilin vit por evidentohet se nuk ka reflektuar pozicionet e lira të krijuara gjatë vitit në këtë akt.

Në lidhje me këtë konstatim, njësia përgjegjëse, duhet të tregojë kujdes që në të ardhmen, në hartimin e planit të nevojave për rekrutim, të reflektojë qartë mangësitë e konstatuara nga Komisioneri dhe ta hartojë këtë akt, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

- Gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit nga ana e njësisë përgjegjëse janë ndjekur të gjitha fazat e kërkuara në aktet ligjore dhe nënligjore, për dokumentacionin e dorëzuar “online” nga kandidatët në “domain”-in: <http://rekrutime.instat.gov.al/shpalljet>, i cili më pas është printuar dhe depozituar në dosjet e konkurrimit. Por nga ana tjetër, rezulton se ky dokumentacion, nuk është evidentuar/regjistruar pranë zyrës së protokollit të institucionit, në përputhje me kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.
- Procedurat e rekrutimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv, nga njësia përgjegjëse janë realizuar me konkurrenca individuale dhe jo konkurrim në grup pozicionesh.

Ky është një aspekt i rëndësishëm i administrimit të procesit të rekrutimit, pasi vë në diskutim zbatimin e parimeve të këtij procesi që janë merita dhe profesionalizmi, të cilat sigurojnë një proces përzgjedhës në drejtim të kandidatëve cilësorë.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse e institucionit, në të ardhmen duhet të kujdeset që për pozicionet e nivelit ekzekutiv, të realizojë procedura konkurrimi sipas grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë, për të tërhequr sa më shumë kandidatë cilësorë në shërbimin civil.

- Njësia përgjegjëse e institucionit për secilën procedurë pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, ka ngritur *Komitetin e Përhershëm të Pranimit*, duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 22, të Ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nënligjore të përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, i cili citon se:

“Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv pranë institucioneve të pavarura dhe njësive të qeverisjes vendore krijohet një komitet i përhershëm i pranimit për secilin institucion”.

Pra, KPP krijohet në fillim të vitit dhe ka të njëjtën përbërje për të gjitha procedurat e konkurrimit për pranim në shërbimin civil të zhvilluara gjatë vitit për këtë kategori nëpunësie.

Njësia përgjegjëse duhet të tregojë kujdes në ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, duke e krijuar në fillim të vitit, me të njëjtën përbërje për të gjitha

procedurat e konkurrimit për pranim në shërbimin civil, të zhvilluara gjatë vitit për këtë kategori nëpunësie, në përputhje me përmbajtjen e nenit 22, të Ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe pikën 2, të kreut III, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar,

→ Vakanca e krijuar në plotësimin e pozicionit të kategorisë së nivelit të lartë drejtues *“Drejtues i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit”*, për një periudhë 2- vjeçare, si rezultat i mungesës së kandidatëve të interesuar për këtë pozicion pune.

Njësia përgjegjëse e institucionit, në kushtet kur ndodhet përpara pamundësisë së plotësimit të pozicioneve të kategorisë së nivelit të lartë drejtues me konkurrim të hapur, si në rastin konkret, legjislacioni i shërbimit civil i njeh të drejtën, për ti plotësuar këto pozicione me pranim nga jashtë shërbimit civil, në respektim të dispozitës së përcaktuar pika 1, neni 32, *“Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore”*, i Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Po kështu, një mundësi tjetër është edhe bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike, për të përdorur listën e pritjes së nëpunësve të lartë drejtues në administratën shtetërore, apo listën e nëpunësve civilë që presin të zbatohet një vendim gjykate për rikthimin në shërbimin civil.

Sa parashtruar më sipër, paraqesin disa elementë paligjshmërie që janë konstatuar nga mbikëqyrja në këtë institucion, të cilat nisur nga natyra e tyre, nuk cënojnë thelbin e proceseve të realizuara dhe në disa raste ato janë korrigjuar nga vet institucioni.

Parregullsitë janë pasqyruar në raport, me qëllim që të sillen në vëmendjen e subjekteve që kanë detyrë të administrojnë shërbimin civil dhe të mos përsëriten në të ardhmen, e ndërkohë do të jenë në fokusin e kontrollit të Komisionerit në vazhdimësi, për të mos lejuar përsëritjen e tyre.

Subjekti i mbikëqyrur, është njohur me projekt raportin nëpërmjet shkresës nr. 216 prot., datë 09.03.2022 dhe e ka dërguar pranë Komisionerit të nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, konstatova se parregullsitë e konstatuara nuk janë të natyrës së shkeljeve ligjore që kërkojnë rregullime të posaçme. Vërejtjet e pasqyruara në këtë akt, janë të karakterit parimor që nuk e cenon në thelb ndonjë prej

proceseve të evidentuara, e në këto kushte, procesi i mbikëqyrjes nuk do të shoqërohet me vendim paralajmërimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, në institucionin Instituti i Statistikave, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion.

Problematikat e evidentuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar, kanë të bëjnë me aspekte të përgjithshme të zbatimit të ligjit, e për këtë arsye, Komisioneri do të përmbyllë procesin pa vendim paralajmërues. Sqarimi me burimet njerëzore e më tej ndjekja e zbatimit të ligjit në proceset me natyrë të ngjashme që do të kryhen rishtas, do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të stafit të Komisionerit.

2. Për këtë vendim të njoftohet Instituti i Statistikave, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha